

08/07/2010, "KOSOVA SOT"

Prishtinë, 7 korrik  
Ministria e Arsimit, Shkencës  
e Teknologjisë (MASHT) në  
bashkëpunim me VUS-  
Austria, Zyra në Prishtinë,  
organizuan seminarin me  
emër: "Programet e për-  
bashkëta dhe njohja  
akademike". Qëlimi i këtij

seminari ishte njohja me  
zhvillimet më të fundit në  
fushën e arsimit të lartë,  
zhvillimi i programeve të për-  
bashkëta dhe trendët  
aktuale në Zonën Evropiane  
të Arsimit të Lartë. Me këtë  
rast Avdulla Alija, drejtor i  
Departamentit për Arsim të

Lartë në MASHT, tha që kjo  
ministri është fokusuar të  
nxisë zhvillimin e programeve  
të përbashkëta dhe njohjet  
reciproke akademike në mes  
Kosovës dhe vendeve të  
ndryshme të Evropës, dhe në  
këtë kontekst Procesi i  
Bolonjës është qenësor

edhe për ndërkombëtarizimin  
e Arsimit të Lartë. Ndërkaq,  
rektori i Universitetit të  
Prishtinës, Mujë Rugova, ndër  
të tjera tha se organizata  
joqeveritare VUS, e special-  
izuar për implementim të pro-  
grameve, ka zhvilluar dhe  
zbatuar në UP më shumë se

100 lëndë të reja mësimore, si  
dhe katër programe master.  
"Këto programe janë zhvilluar  
në bashkëpunim shumë të  
ngushtë me universitetet part-  
nere nga Austria, ndërkohë po  
mundohej që sa më shumë  
ta lidhim Universitetin e  
Prishtinës me ekonominë dhe

nevojat tregut të punës", the-  
soi rektori Rugova. Në anën  
tjetër, Kristian Geosits, nga  
Austria potencoi që VUS-  
Austria është e përkushtuar  
që edhe më tej të mbështesë  
zhvillimet programore dhe  
ndërkombëtarizimin e Arsimit  
të Lartë të Kosovës. V.R

**MASHT-i angazhohet për ndërkombëtarizimin e Arsimit të Lartë të Kosovës**